



BULETIN MUJOR

PRILL 2025



PËRMBAJTJA

Trajnim Praktik mbi Sigurinë Kibernetike me Platformën SimSpace në Laboratorin e AKSK



Në Laboratorin e Sigurisë Kibernetike të AKSK, u mbajt një trajnim praktik për sigurinë kibernetike duke përdorur platformën SimSpace, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit si dhe nga institucionet e pavarura.

Përmes simulimeve reale të sulmeve në këtë platformë, pjesëmarrësit testuan reagimin ndaj skenarëve komplekse dhe forcuan aftësitë e tyre teknike në kushte të kontrolluara dhe sfiduese. Ky aktivitet është pjesë e strategjisë sonë për të fuqizuar mbrojtjen kibernetike në sektorët më të rëndësishëm të vendit.



AKSK takim ndërgjegjësues me nxënësit mbi sigurinë në internet dhe rreziqet online

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike zhvilloi në shkollën 9-vjeçare “Emin Duraku” një takim ndërgjegjësues me nxënësit mbi sigurinë në internet dhe rreziqet që lidhen me përdorimin e rrjeteve sociale.

Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe ASHDMF, me qëllim edukimin e të rinjve për një qasje më të sigurt dhe të përgjegjshme në hapësirën digjitale.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



@aks.gov.al



+355 422 21 039



AKSK zhvilloi trajnim teknik “Live Fire” me simulime reale në Laboratorin e Sigurisë Kibernetike

AKSK zhvilloi një trajnim teknik "Live Fire" mbi sistemet OT (Operational Technology) në Laboratorin e Sigurisë Kibernetike, me pjesëmarrjen e studentëve të Canadian Institute of Technology (CIT).

Aktiviteti, me fokus në mbrojtjen e infrastrukturave kritike, u organizua përmes një simulimi Red Team vs Blue Team, ku u inskenua një skenar realist i një sulmi kibernetik dhe përgjigjja ndaj tij në kohë reale. Red Team ndërmori sulme të avancuara mbi sistemet industriale, ndërsa Blue Team zbatoi teknika të zbulimit dhe rikuperimit duke përdorur mjete si SIEM.

Studentët analizuan të gjitha fazat e simulimit dhe diskutuan mbi praktikat më të mira për mbrojtjen e teknologjisë operacionale, duke përfituar një përvojë praktike mbi sfidat reale të sigurisë kibernetike.

Aktivitet Ndërgjegjësues në Qendrat Ditore të Moshuarve

Në kuadër të angazhimit tonë për gjithëpërfshirjen e grupeve të nënpërfaqësura, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, ka zhvilluar një seri sesionesh ndërgjegjëse për të moshuarit në qendrat ditore në Tiranë, Durrës, Shkodër, Korçë dhe Vlorë.

Këto takime synojnë të informojnë të moshuarit mbi përdorimin e sigurt të internetit, mbrojtjen nga mashtrimet online dhe njohjen e rreziqeve të hapësirës digjitale.



Sfida e Kërcënimeve Kibernetike të ENISA 2030 ndaj Shqipërisë përmes Edukimit dhe Ndërgjegjësimit

AKSK në bashkëpunim me CIT organizoi një workshop me fokus në forcimin e sigurisë kibernetike përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit. Aktiviteti mbledhi profesionistë dhe studentë për të diskutuar sfidat dhe ndërtimin e reziliencës ndaj kërcënimeve në zhvillim, në kuadër të vizionit të ENISA 2030 për një të ardhme digjitale më të sigurt në Shqipëri.